

**L I G J**  
**Nr.8466, datë 24.3.1999**

**PËR ANTIDUMPINGUN**

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 e Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I:**

**PJESA I**  
**QËLLIMI, PËRKUFIZIMET DHE PARIMET**

**Neni 1**

**Qëllimi**

Ky ligj ka për qëllim të mbrojë prodhimin vendas në rastet kur dëmtohet dhe pengohet nga praktika të pandershme të tregtisë ndërkombëtare nëpërmjet dumpingut.

**Neni 2**

**Përkufizime**

Në kuptim të këtij ligji:

a) me “dumping” kuptohet futja e një produkti në tregun e një vendi me çmim më të ulët se vlera e tij normale;

b) me “kufi i dumpingut” kuptohet diferenca ndërmjet çmimit të eksportit dhe vlerës normale në bazë të krahasimit sipas dispozitave të këtij ligji;

c) me “dëmtim” kuptohet dëmi pasuror që i shkaktohet industrisë së vendit, kërcënimi për dëmtim pasuror të industrisë së vendit ose pengimi i krijimit të industrisë së vendit;

ç) me “industri të vendit” kuptohen prodhuesit shqiptarë të produkteve të ngjashme, ose vetëm ajo pjesë e tyre, produkti i përbashkët i të cilëve përbën një pjesë të madhe të prodhimit të përgjithshëm vendas të këtyre produkteve;

d) me “prodhues të lidhur” kuptohen prodhuesit vendas, që konsiderohen se lidhen me eksportues ose importues vetëm nëse njëri prej tyre drejtpërdrejt ose tërthorazi kontrollon tjetrin ose nëse të dy së bashku kontrollohen drejtpërdrejt ose tërthorazi nga një person i tretë, ose kur së bashku ata kontrollojnë drejtpërdrejt ose tërthorazi një person të tretë;

dh) me “produkte të ngjashme” kuptohet produkti që është krejt i ngjashëm me produktin në fjalë, ose në mungesë të një produkti të tillë, një tjetër produkt që megjithëse jo krejt i njëjtë ka karakteristika shumë të ngjashme me ato të produktit në fjalë;

e) me “Zyrë Antidumping” kuptohet organi shtetëror i ngarkuar për kryerjen e hetimeve dhe vendosjen e taksave antidumping;

ë) me “hetim” kuptohet shqyrtimi për të përcaktuar ekzistencën, shkallën dhe efektin e dukurisë dumping;

f) me “palë të interesuara” kuptohen:

- eksportuesit ose prodhuesit e huaj të produktit nën hetim;

- importuesit e produktit nën hetim;

- shoqata biznesi ose tregtie, pjesa me e madhe e anëtarëve të të cilave janë prodhues,

eksportues ose importues të produktit nën hetim;

- qeveritë e vendeve eksportuese;
- prodhuesit vendas të produktit të ngjashëm;
- shoqata biznesi ose tregtie, pjesa më e madhe e anëtarëve të të cilave prodhojnë produktin e ngjashëm vendas.

### Neni 3

#### **Parime**

1. Një produkt konsiderohet objekt i dumpingut nëse çmimi i eksportit të produktit të eksportuar në Republikën e Shqipërisë është më i ulët se çmimi i krahasueshëm për produktin e ngjashëm kur është i destinuar për konsum, në kushtet normale të tregtimit në vendin eksportues.

2. Vendi eksportues është zakonisht vendi i origjinës. Megjithatë ai mund të jetë një vend ndërmjetës, përveçse kur produkti vetëm kalon përmes vendit ndërmjetës, ose nuk është prodhuar në vendin ndërmjetës dhe mund të mos ketë çmim në këtë vend.

3. Zyra Antidumping merr vendime për vendosjen e një takse antidumping për produktet objekt i dumpingut, vetëm kur ajo vendos se qarkullimi i lirë i këtyre produkteve në Republikën e Shqipërisë do të shkaktonte një dëm material për industrinë vendase.

### PJESA II

#### **PËRCAKTIMI I DUMPINGUT, DËMIT PASUROR DHE LIDHJES SHKAKËSORE**

### KREU 1

#### **PËRCAKTIMI I DUMPINGUT**

### Neni 4

#### **Vlera normale**

1. Për të përcaktuar fenomenin e dumpingut Zyra Antidumping duhet të përcaktojë vlerën normale të produktit në bazë të çmimit të krahasueshëm, të paguar apo të pagueshëm, nga blerës të pavarur, në kushte normale tregtimi, kur ky produkt destinohet për konsum në vendin eksportues.

2. Sasi e mjaftueshme e shitjes së produkteve të ngjashme në tregun e brendshëm të vendit eksportues për përcaktimin e vlerës normale, do të konsiderohet 5 për qind ose më shumë e shitjes në Republikën e Shqipërisë së produktit të shqyrtuar, me kusht që raporti më i ulët të jetë i pranueshëm aty ku vërtetohet me fakte që shitjet, në vend me raport të tillë, lejojnë kryerjen e një krahasimi të saktë.

3. Kur nuk ka shitje të produktit të ngjashëm në kushtet normale të tregtimit në tregun e brendshëm të vendit eksportues, ose kur për shkak të situatës së veçantë të tregut apo vëllimit të ulët të shitjeve në tregun e brendshëm të vendit eksportues, shitje të tilla nuk lejojnë një krahasim të drejtë, vlera normale e produktit nën hetim do të përcaktohet në bazë të kriterëve si vijon:

- a) çmimit të krahasueshëm të produktit të ngjashëm kur eksportohet në një vend të tretë;
- b) koston së prodhimit në vendin e origjinës, duke i shtuar një shumë të arsyeshme që përfshin koston e shitjeve, kostot administrative e të përgjithshme dhe fitimet.

### Neni 5

#### **Trajtimi i shitjeve nën kosto si shitje në kushte jonormale tregtimi**

1. Zyra Antidumping do të marrë parasysh në përcaktimin e vlerës normale ato shitje që bëhen në kushte normale. Ajo i trajton shitjet e produktit të ngjashëm në tregun e brendshëm të

vendit eksportues ose shitjet në një vend të tretë me një çmim më të ulët se kosto e përgjithshme për njësi prodhimi (kosto fikse e variabël të prodhimit, administrative, të shitjeve dhe të përgjithshme), si jo në kushte normale tregtimi për shkak të çmimit dhe mund të mos i marrë parasysh shitje të tilla në përcaktimin e vlerës normale, vetëm nëse ajo përcakton si vijon:

- shitje të tilla janë bërë për një periudhë të konsiderueshme kohe (normalisht një vit, por në asnjë rast më pak se gjashtë muaj);

- shitje të tilla bëhen në sasi të konsiderueshme. Zyra Antidumping do t'i konsiderojë shitjet nën kosto për njësi në sasi të konsiderueshme;

- kur përcakton që mesatarja e ponderuar e çmimit së shitjes së transaksioneve nën shqyrtim për të përcaktuar vlerën normale, është më e ulët se mesatarja e ponderuar e kostove për njësi, ose kur vëllimi i shitjeve nën kosto për njësi paraqet jo më pak se 20 për qind të vëllimit të shitur të transaksioneve që shqyrtohen për të përcaktuar vlerën normale;

- shitje të tilla bëhen me çmime që nuk mund të mbulojnë të gjitha kostot brenda një periudhe të arsyeshme kohe.

Nëse çmimet nën kosto për njësi, në kohën e shitjeve janë mbi mesataren e ponderuar të kostove për njësi në periudhën e hetimit, Zyra Antidumping duhet të llogarisë se çmime të tilla lejojnë mbulimin e kostove brenda një periudhe të arsyeshme kohe.

2. Në kuptim të nenit 4 pika 3, Zyra Antidumping, si rregull, llogarit kostot në bazë të të dhënave nga eksportuesi apo prodhuesi nën hetim, me kusht që këto të dhëna të jenë në përputhje me parimet e përgjithshme të kontabilitetit të vendit eksportues dhe të pasqyrojnë në mënyrë të arsyeshme kostot e lidhura me produktin dhe shitjen e produktit nën shqyrtim.

#### Neni 6

#### **Çmimi i eksportit**

1. Çmimi i eksportit është çmimi aktualisht i paguar ose i pagueshëm sot për sot për produktin kur shitet për eksport nga vendi eksportues në Republikën e Shqipërisë.

2. Në rastet kur nuk ka çmim eksporti, ose kur ky çmim konsiderohet i pabesueshëm nga Zyra Antidumping për shkak të lidhjes ose të një marrëveshjeje shpërblimi ndërmjet eksportuesit dhe importuesit ose një pale të tretë, çmimi i eksportit mund të ndërtohet mbi kriteret si vijon:

- a) në bazë të çmimit me të cilin produktet e importuara i janë rishitur fillimisht një blerësi të pavarur;

- b) në bazë të një çmimi të arsyeshëm që do të përcaktojë Zyra Antidumping, kur produktet nuk i janë rishitur një blerësi të pavarur ose nuk janë rishitur në të njëjtën gjendje siç janë importuar.

#### Neni 7

#### **Faktorët bazë për krahasimin ndërmjet vlerës normale dhe çmimit të eksportit**

1. Faktorët bazë që ndikojnë në krahasueshmërinë e çmimit janë: kushtet e shitjes, taksat, nivelet e tregtisë, sasitë, karakteristikat fizike dhe çdo ndryshim tjetër, që vërtetohet nga palët e interesuara se ndikon në krahasueshmërinë e çmimit.

Meqenëse disa nga faktorët e mësipërm mund të ndërthuren, Zyra Antidumping duhet të sigurojë se rregullimet nuk do të jenë të dubluara.

2. Zyra e Antidumpingut njofton palët për informacionin që është i nevojshëm për të siguruar një krahasim të drejtë dhe nuk vendos për një barrë të paarsyeshme provash mbi palët.

Neni 8  
**Metodat e krahasimit**

Në përputhje me rregullat e parashikuara në nenin 7, paragrafi 1, ekzistenca e dumpingut do të përcaktohet, si rregull, mbi bazën e krahasimit të mesatares së ponderuar të vlerës normale me një mesatare të ponderuar të çmimeve të të gjitha transaksioneve të krahasueshme të eksportit ose mbi bazën e krahasimit të vlerës normale dhe çmimeve të eksportit mbi një bazë transaksion për transaksion.

Një vlerë normale e vendosur mbi bazën e mesatares së ponderuar, mund të krahasohet me çmimet e transaksioneve individuale të eksportit, nëse Zyra Antidumping gjen një model të çmimeve të eksportit, që ndryshon ndjeshëm për blerës, rajone apo periudha kohore të ndryshme. Në të tilla rrethana, Zyra Antidumping jep shpjegime për arsyet e mosmarrjes parasysh të këtyre diferencave.

Neni 9  
**Këmbimi i monedhës**

Kur krahasimi kërkon konvertim të monedhës, Zyra Antidumping duhet të bëjë një këmbim të tillë duke përdorur kursin zyrtar mesatar të këmbimit të datës së shitjeve.

Datë e shitjes konsiderohet si data e kontratës, e porosisë së blerjes, e konfirmimit të porosisë ose e faturës, në të cilën vendosen kushtet materiale të shitjes.

Zyra Antidumping nuk do të marrë parasysh luhatjet në kursin e këmbimit dhe do t'u lejojë eksportuesve të paktën 60 ditë të rregullojnë çmimet e tyre të eksportit, për të pasqyruar lëvizjet e bëra në kurset e këmbimit gjatë periudhës së hetimit.

KREU 2  
**PËRCAKTIMI I DËMIT PASUROR DHE LIDHJES SHKAKËSORE**

Neni 10  
**Përcaktimi i dëmit**

Përcaktimi i dëmit do të bazohet në fakte dhe përfshin shqyrtimin objektiv të elementeve si vijon:

- a) vëllimit të importeve objekt i dumpingut;
- b) efektin e importeve objekt i dumpingut në çmimet e produkteve të ngjashme në tregun e brendshëm;
- c) ndikimin e mëtejshëm të këtyre importeve mbi prodhuesit e brendshëm të produkteve të tilla.

Neni 11  
**Përcaktimi i vëllimit të importeve objekt i dumpingut**

Zyra Antidumping për vëllimin e importeve objekt i dumpingut, duhet të shqyrtojë nëse ka një rritje të konsiderueshme në këto importe, si në vlerë absolute, ashtu edhe në raport me prodhimin ose konsumin në Republikën e Shqipërisë.

Neni 12  
**Përcaktimi i efektit të importeve, objekt i dumpingut, mbi çmimet në vend**

1. Zyra Antidumping, për të përcaktuar efektet e importeve, objekt i dumpingut, në çmimet në tregun e Republikës së Shqipërisë, duhet të shqyrtojë:

a) nëse ka pasur një rënie të theksuar çmimi të importeve nën dumping krahasuar me çmimin e produkteve të ngjashme në Republikën e Shqipërisë;

b) nëse këto importe shkaktojnë uljen e ndjeshme të çmimeve ose pengojnë rritjen e ndjeshme të çmimeve, që do të kishte ndodhur në mungesë të importeve objekt i dumpingut.

2. Kur importet e produkteve të ngjashme nga më shumë se një vend janë njëherësh subjekt i hetimeve antidumping, Zyra Antidumping mund të vlerësojë në mënyrë të shtuar (së bashku) efektet e këtyre importeve vetëm nëse përcakton si vijon:

a) kufiri i dumpingut i vendosur për importet nga secili vend është më i madh se minimali (de minimis) dhe vëllimi i importeve nga secili vend nuk është i papërfillshëm, siç specifikohen në nenin 18 pika 6, të këtij ligji;

b) vlerësimi (së bashku) i efekteve të importeve është me vend në kushtet e konkurrencës ndërmjet produkteve të importuara dhe produkteve të brendshme të ngjashme.

#### Neni 13

##### **Përcaktimi i efektit të importeve, objekt i dumpingut, në industrinë vendase**

1. Shqyrtimi i ndikimit të importeve, objekt i dumpingut, në industrinë vendase përkatëse përfshin vlerësimin nga Zyra Antidumping e të gjithë faktorëve dhe treguesve ekonomikë përkatës, që kanë lidhje me gjendjen e industrisë, duke përfshirë elementet si vijon:

a) rënien aktuale dhe potenciale në shitjet, fitimet, rezultatet, pjesën sunduese në treg, produktivitetin, të ardhurat nga investimet, ose në përdorimin e kapaciteteve;

b) faktorët që ndikojnë në çmimet e brendshme;

c) madhësinë e kufijve të dumpingut;

ç) efektet negative, aktuale dhe potenciale, mbi likuiditetet, inventaret, punësimin, pagat, rritjen apo aftësinë për të rritur kapitalin ose investimet.

2. Zyra Antidumping duhet të vlerësojë efektet e importeve dumping lidhur me prodhimin shqiptar të produkteve të ngjashme, kur të dhënat në dispozicion lejojnë identifikimin e veçantë të atij produkti, në bazë të kriterëve të tilla, si procesi i prodhimit, shitjet dhe fitimet e prodhuesit. Nëse një identifikim i tillë i veçantë për këtë produkt nuk është i mundur, këto efekte vlerësohen nga shqyrtimi i prodhimit të një grupi më të ngushtë produktesh, i cili përfshin produkte të ngjashme për të cilat mund të sigurohet informacioni i nevojshëm.

#### Neni 14

##### **Kërcënimi për dëm pasuror**

Zyra Antidumping bazon përcaktimin e vet për kërcënim me dëm pasuror në fakte dhe jo thjesht në deklarata të pavërtetuara.

Për rastet kur kërcënimi me dëm pasuror vjen nga importet, objekt i dumpingut, Zyra Antidumping do të shqyrtojë dhe do të vendosë masa antidumping, duke marrë parasysh edhe faktorë të tillë si :

a) rritjen e theksuar në përqindje të importeve objekt i dumpingut;

b) efektin zvogëlues të këtyre importeve në çmimet vendase duke rritur kërkesën për importe.

#### Neni 15

##### **Lidhja shkakësore**

Zyra Antidumping duhet të tregojë se produktet, objekt i dumpingut, nëpërmjet efekteve të dumpingut të parashikuara në nenet e këtij kreu, shkaktojnë dëm pasuror sipas kuptimit të këtij ligji. Vërtetimi i lidhjes shkakësore ndërmjet importeve objekt i dumpingut dhe dëmit pasuror për industrinë vendase bazohet në shqyrtimin e të gjitha fakteve përkatëse në dispozicion të Zyrës

Antidumping. Kjo e fundit duhet, gjithashtu, të shqyrtojë çdo fakt a rrethanë të njohur, përveç importeve objekt i dumpingut, të cilat në të njëjtën kohë dëmtojnë industrinë vendase. Dëmet e shkaktuara nga këta faktorë nuk duhet t'i atribuohen importeve objekt i dumpingut.

### **PJESA III ORGANET E HETIMIT**

Neni 16

#### **Zyra Antidumping**

Për zbatimin e dispozitave të këtij ligji krijohet Zyra Antidumping si një institucion publik në varësi të ministrit që mbulon tregtinë. Zyra Antidumping drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm, i cili emërohet dhe shkarkohet nga Këshilli i Ministrave. Zyra Antidumping ka në përbërje të saj struktura hetimi dhe vendimmarrëse. Vendimet për taksat antidumping merren nga Komisioni Antidumping, i cili përbëhet nga shtatë anëtarë. Anëtarët e komisionit propozohen nga Këshilli i Ministrave dhe miratohen nga Kuvendi për një periudhë gjashtëvjeçare.

### **PJESA IV HETIMET**

#### **KREU 1 FILLIMI I HETIMIT**

Neni 17

#### **Kërkesa dhe plotësimi i formularëve**

1. Hetimi për të përcaktuar ekzistencën, shkallën dhe efektin e dukurisë dumping të deklaruar fillon vetëm me kërkesën me shkrim, nga ose në emër të industrisë vendase. Në rrethana të veçanta, Zyra Antidumping, mund të fillojë një proces edhe pa marrë një kërkesë me shkrim nga ose në emër të industrisë së vendit. Në një rast të tillë, Zyra Antidumping vepron vetëm nëse ka të dhëna të mjaftueshme të dukurisë dumping, dëmit pasuror dhe lidhjes shkakësore, sipas Pjesës II të këtij ligji, të cilat përbëjnë një bazë ligjore për fillimin e hetimit.

2. Kërkesa për hetim i drejtohen Zyrës Antidumping sipas formularëve të caktuar prej saj.

3. Formulari, sipas paragrafit 1 të këtij neni, do të përfshijë arsyet për ekzistencën e dukurisë dumping, dëmit pasuror dhe lidhjes shkakësore sipas Pjesës II të këtij ligji.

Neni 18

#### **Vendimi për fillimin e hetimit**

1. Zyra Antidumping duhet të shqyrtojë saktësinë dhe sasinë e mjaftueshme të të dhënave të përshkruara në formular për të përcaktuar nëse ato përbëjnë bazën e duhur për të filluar hetimin.

2. Organet doganore detyrohen të japin informacionet e nevojshme të kërkuara nga Zyra Antidumping.

3. Në rastet kur Zyra Antidumping duhet të fillojë hetimin vetëm pasi të këtë përcaktuar se aplikimi është bërë nga ose në emër të industrisë së vendit dhe ka të dhëna të mjaftueshme të dukurisë dumping, dëmit pasuror dhe lidhjes shkakësore sipas pjesës II të këtij ligji.

Kur Zyra Antidumping vendos se nuk plotësohen kushtet e këtij paragrafi, ajo njofton aplikantët për arsyet e mosfillimit të hetimit.

4. Zyra Antidumping, si rregull, duhet të vendosë për fillimin ose mosfillimin e një

hetimi antidumping, brenda 45 ditëve nga data e paraqitjes së aplikimit. Kur aplikimi përfshin çështje komplekse ose kur Zyra Antidumping ka kërkuar informacion shtesë nga aplikuesi, kjo kohë mund të shtyhet deri në 60 ditë.

5. Çdo kërkesë mund të tërhiqet para fillimit të procesit të hetimit dhe në këtë rast do të konsiderohet se nuk është bërë.

6. Zyra Antidumping nuk duhet të fillojë një hetim që ka lidhje me produktin e deklaruar objekt i dumpingut, nëse nga informacioni i disponuar në mënyrë të arsyeshme, përcakton se kufiri i dumpingut është minimal, më i vogël se 2 për qind ose vëllimi aktual apo potencial, i importeve nën dumping është i papërfillshëm.

Vëllimi i importit do të konsiderohet i papërfillshëm nëse vëllimi i importeve vetëm nga një vend, zë më pak se 3 për qind të tregut të konsumit vendas, me përjashtim të rasteve kur importet individuale të vendeve, që zënë më pak se 3 për qind të konsumit vendas, së bashku zënë më pak se 7 për qind të këtij konsumi.

#### Neni 19

#### **Aplikimi nga ose në emër të industrisë vendase**

Në kuptim të këtij ligji një aplikim do të konsiderohet i bërë “nga ose në emër të industrisë së vendit” vetëm nëse përmbushen elementet si vijon:

a) gëzon mbështetjen e prodhuesve shqiptarë, prodhimi i të cilëve përbën më shumë se 50 për qind të prodhimit të përgjithshëm vendas të produkteve të ngjashme, që prodhohet nga ajo pjesë e industrisë vendase të cilët shprehen pro ose kundër aplikimit;

b) prodhuesit vendas, që shprehen për mbështetjen e aplikimit, të përbëjnë jo më pak se 25 për qind të prodhimit total të produktit të ngjashëm nga industria vendase.

#### Neni 20

#### **Publikimi i kërkesës**

1. Deri në marrjen e vendimit për fillimin e hetimit, Zyra Antidumping ndalohet të publikojë çdo kërkesë për fillimin e hetimit.

2. Megjithatë pas marrjes së një kërkesë që plotëson kërkesat e nenit 18, Zyra Antidumping duhet të njoftojë qeverinë e vendit përkatës eksportues.

#### Neni 21

#### **Publikimi i fillimit të hetimit**

Kur vendos për fillimin e hetimit, Zyra Antidumping duhet ta njoftojë këtë në median e shkruar të përditshme dhe/ose në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe të njoftojë për fillimin e hetimit shtetet, produktet e të cilave janë subjekt i hetimit dhe palët e interesuara që dihet se kanë interesa aty.

#### KREU 2

#### **ZHVILLIMI I HETIMEVE**

#### Neni 22

#### **Parime të përgjithshme**

1. Zyra Antidumping, përveç rasteve të veçanta, duhet të mbyllë hetimet antidumping brenda një viti dhe në asnjë rast nuk mund t'i zgjasë hetimet më shumë se 18 muaj pas fillimit të tyre.

2. Procedura antidumping nuk duhet të pengojë procedurat e shlyerjeve të detyrimeve

doganore. Me marrjen e masave, nuk kryhet asnjë formalitet tjetër shtesë, përveç atyre që kërkohen për zbatimin e këtyre masave.

3. Çdo informacion, që konsiderohet konfidencial, do të trajtohet si i tillë nga Zyra Antidumping duke treguar arsyen.

#### Neni 23

### **E drejta e palëve të interesuara për informim**

Zyra Antidumping duhet të krijojë dhe të mbajë një regjistër publik lidhur me çdo hetim ose rishikim. Ky regjistër publik duhet t'i lejohet publikut të gjere për t'u parë dhe kopjuar.

#### Neni 24

### **Mbledhja e informacionit**

1. Zyra Antidumping, me fillimin e hetimeve, duhet t'u dërgojë pyetësorë të gjithë personave që mendon se mund të kenë dijeni për çështjen në hetim, përfshirë prodhuesit vendas, importuesit, eksportuesit dhe prodhuesit e huaj që njihen prej saj.

Këta të fundit duhet të përgjigjen me shkrim, jo më vonë se 40 ditë nga dita e marrjes së pyetësorit apo e transmetimit, zyrës përkatëse diplomatike apo përfaqësuesit zyrtar të vendit eksportues.

2. Për të verifikuar informacionin e mbledhur, apo për të siguruar detaje të mëtejshme, Zyra Antidumping mund të kryejë hetime edhe në territoret e vendeve të tjera, me kusht që shoqëritë përkatëse dhe qeveria e atij vendi të kenë dhënë lejen e tyre, pas njoftimit paraprak zyrtar, të bërë nga Zyra Antidumping.

#### Neni 25

### **Dëgjimi i palëve**

1. Palët e interesuara nuk janë të detyruara të marrin pjesë në takim dhe kjo nuk sjell pasoja për çështjen e asnjërës palë.

2. Palët e interesuara, gjithashtu, kanë të drejtën që të paraqesin gojarisht edhe informacion tjetër, gjatë takimeve me zyrtarë të organit kompetent. Zyra Antidumping duhet ta marrë në konsideratë informacionin gojor, vetëm nëse është riprodhuar më vonë me shkrim (ose regjistruar) dhe i është vënë në dispozicion palëve të tjera të interesuara.

#### Neni 26

### **Kontributi i organizatave përfaqësuese të konsumatorëve dhe përdoruesve industrialë**

Zyra Antidumping për të propozuar masat përkatëse duhet t'u krijojë mundësi përdoruesve industrialë të produktit nën hetim në Republikën e Shqipërisë, si dhe organizatave përfaqësuese të konsumatorëve në rastet kur produkti shitet me pakicë në Republikën e Shqipërisë, që të japin informacion ose argumente për çështje që kanë të bëjnë me hetimin, përfshirë interesat e Republikës së Shqipërisë. Informacionet dhe argumentet duhet të jepen me shkrim.

Zyra Antidumping duhet të lejojë që përdoruesit industrialë të produkteve nën hetim dhe organizatat përfaqësuese konsumatore të bëjnë paraqitjen gojore në çdo takim të mbajtur gjatë hetimit.

#### Neni 27

### **Përcaktimi përfundimtar dhe publikimi**

1. Zyra Antidumping, të paktën 30 ditë para se të merret vendimi përfundimtar, duhet të njoftojë me shkrim të gjitha palët e interesuara, subjekt i kërkesës për mbrojtjen e konfidencialitetit të informacionit, për faktet themelore nën shqyrtim, që përbëjnë bazat për vendimin ose për zbatimin e masave përfundimtare.

Palët e interesuara duhet të dërgojnë komentet me shkrim brenda 15 ditëve nga çasti i marrjes së këtij njoftimi.

2. Hetimi duhet të mbyllet me një vendim përfundimtar pohues ose mohues. Zyra Antidumping duhet të bëjë një njoftim publik të vendimit përfundimtar. Njoftimi duhet të përfshijë të gjitha informacionet përkatëse mbi bazën ligjore, faktet dhe arsyet që çuan në këtë përcaktim, kujdesin që është treguar për ruajtjen e informacionit konfidencial.

Njoftimi duhet të botohet në median e shkruar të përditshme dhe/ose në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe duhet t'i dërgohet edhe vendit produktet e të cilit janë subjekt i këtij përcaktimi, si dhe palëve të tjera të interesuara.

3. Pas daljes së vendimit përfundimtar, me kërkesë të bërë brenda 15 ditëve nga publikimi i tij, Zyra Antidumping duhet të zhvillojë mbledhje të veçanta, të hapura me eksportues ose prodhues që kërkojnë këtë takim, për të shpjeguar metodologjinë e përdorur në llogaritjen e dumpingut të zbatuara përfundimisht për produktet e atij eksportuesi ose prodhuesi.

#### KREU 3

### **PËRFUNDIMI I HETIMIT**

#### Neni 28

### **Masat e përkohshme**

1. Zyra Antidumping mund të propozojë vendosjen e masave të përkohshme, nëse ka filluar hetimi sipas dispozitave të nenit 17, është bërë njoftimi publik, palëve të interesuara u janë krijuar mundësitë për të dërguar informacionin dhe për të bërë komente, është bërë një përcaktim pohues paraprak i dumpingut dhe i dëmit pasuror për industrinë e vendit, dhe interesi i Republikës së Shqipërisë kërkon të merren masat e përkohshme për të penguar vazhdimin dhe shtimin e dëmit pasuror gjatë hetimit.

2. Masat e përkohshme mund të merren në formën e taksave të përkohshme ose të një garancie nëpërmjet një depozite në para apo obligacione, jo më të madhe se kufiri i dumpingut të vlerësuar paraprakisht.

3. Masat e përkohshme nuk zbatohen më parë se 60 ditë nga fillimi i hetimit.

4. Masat e përkohshme zbatohen për një periudhë jo më shumë se 6 muaj nga fillimi i hetimit. Me kërkesën e eksportuesve që zënë një përqindje të rëndësishme të tregut të përfshirë në hetim, Zyra Antidumping mund të propozojë zgjatjen e periudhës së zbatimit të masave të përkohshme për një periudhë jo më shumë se 9 muaj.

5. Në zbatimin e masave të përkohshme zbatohen kushtet e parashikuara në nenin 32 të këtij ligji.

#### Neni 29

### **Angazhimet**

1. Zyra Antidumping mund të pezullojë një hetim, pa vendosjen e masave të përkohshme të taksave antidumping, kur sigurohet se, me marrjen e angazhimeve të kënaqshme vullnetare nga çdo eksportues për të riparë çmimet ose për të ndërprerë eksportet me çmime objekt i dumpingut

në vendin në fjalë, do të zhdukeshin efektet e dëmshme të dumpingut.

2. Angazhimi për çmime mund të sugjerohet nga Zyra Antidumping, por asnjë eksportues nuk detyrohet të hyjë në të tilla angazhime. Fakti që eksportuesit nuk marrin përsipër angazhime të tilla apo nuk pranojnë ftesën për një gjë të tillë, nuk ndikon në asnjë mënyrë në shqyrtimin e çështjes.

3. Zyra Antidumping mund t'i kërkojë çdo eksportuesi, angazhimet e të cilit janë pranuar, të informojë periodikisht për plotësimin e këtyre angazhimeve dhe të lejojë verifikimin e të dhënave përkatëse. Komunikimi i këtyre të dhënave duhet t'i nënshtrohet dispozitave përkatëse për konfidencialitetin. Mosdhënien e informacionit të kërkuar, Zyra Antidumping mund ta konsiderojë shkelje të angazhimit.

#### Neni 30

#### **Refuzimi i angazhimit**

1. Angazhimet për çmimin të bëra nga eksportuesit nuk duhet të kërkojnë ose pranohen nga Zyra Antidumping, nëse kjo e fundit nuk ka dhënë ende një përcaktim pohues paraprak të dumpingut, të dëmit pasuror dhe të lidhjes shkakësore.

2. Angazhimet e ofruara nuk pranohen, nëse Zyra Antidumping i konsideron të papërshtatshme. Kur Zyra Antidumping vendos të mos e pranojë angazhimin, duhet të njoftojë eksportuesin për arsyet që çuan në përcaktimin e angazhimit si të papërshtatshëm. Zyra Antidumping, sipas rastit, duhet t'u japë mundësi eksportuesve të paraqesin komentet me shkrim për këtë çështje.

#### Neni 31

#### **Shkelja e angazhimeve**

Në rastet kur vërehet shkelja e angazhimeve, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, Zyra Antidumping mund të ndërmarrë veprime të menjëhershme, që kanë të bëjnë me propozimin për vendosje të menjëhershme të masave të përkohshme duke përdorur informacionin më të mirë në dispozicion të saj. Në këto raste, mund të vendosen, sipas këtij ligji, taksa përfundimtare për mallrat që kanë hyrë për konsum jo më shumë se 90 ditë para zbatimit të masave të tilla të përkohshme, por një vlerësim i tillë nuk do të këtë veprim prapaveprues.

#### Neni 32

#### **Përfundimi i hetimit pa miratimin e masave**

1. Zyra Antidumping e mbyll hetimin pa propozuar të merren masa, në rast se kërkesa për hetim tërhiqet në çdo kohë pas fillimit të hetimit, përveçse rastit kur Zyra Antidumping vendos se vazhdimi i hetimit është në interes të Republikës së Shqipërisë.

2. Një hetim mund të mbyllet menjëherë sa herë që Zyra Antidumping krijon bindjen se nuk ka të dhëna të mjaftueshme për ekzistencën e dumpingut, të dëmit pasuror, që mund të justifikonte vazhdimin e hetimit ose kur përcakton se kufiri i dumpingut është minimal, apo vëllimi aktual ose potencial i importeve objekt i dumpingut apo i dëmit, është i papërfillshëm sipas përcaktimeve të nenit 18 pika 6 e këtij ligji.

#### Neni 33

#### **Vendosja dhe mbledhja e taksave antidumping**

1. Kur Zyra Antidumping ka përcaktuar se plotësohen kërkesat për të propozuar vendosjen e masave antidumping, duhet të shqyrtojë nëse vendosja e këtyre masave do të ishte në interes të Republikës së Shqipërisë. Interesi i Republikës së Shqipërisë do të përfshijë, përveç

interesit të industrisë shqiptare, situatën e konkurrencës së brendshme për produktet nën hetim, nevojat e përdoruesve industrialë dhe, kur është e mundur, interesin e konsumatorëve.

2. Taksat antidumping duhet të marrin formën e taksave mbi vlerë (ad valorem), specifike ose të ndryshueshme.

3. Taksat antidumping duhet të vendosen krahas taksave të tjera ekzistuese, të importit të vendosura për produktet përkatëse të importuara. Taksat antidumping duhet të mbliken nga organet doganore, në masën e duhur, në çdo rast, mbi baza jodiskriminuese për importet objekt i dumpingut dhe që shkaktojnë dëm pasuror, nga burime të ndryshme, përveç importeve nga ato burime, angazhimet mbi çmimin e të cilave janë pranuar sipas dispozitave të këtij ligji.

#### Neni 34

#### **Prapaveprimi**

1. Përveç sa parashikohet në nenin 31, masat e përkohshme dhe taksat antidumping do të zbatohen vetëm për produktet që hyjnë në Republikën e Shqipërisë për konsum në datën e publikimit të përcaktimit pohues, paraprak ose përfundimtar të hetimit dhe në vazhdim.

2. Kur Zyra Antidumping bën një përcaktim përfundimtar për dëm pasuror, por jo të kërcënimit për dëm, apo të vonës materiale të krijimit të një industrie, ose një përcaktim përfundimtar të kërcënimit për dëm pasuror, mund të propozojë për vendosjen e taksave përfundimtare antidumping, në mënyrë prapavepruese, për periudhën kur janë zbatuar masat e përkohshme, që mund të jenë vendosur, nëse e konsideron se efekti i importeve, objekt i dumpingut, në mungesë të masave të përkohshme, do të kishte çuar në përcaktim të dëmit pasuror.

Në rastin kur taksa përfundimtare antidumping, është më e lartë ose më e ulët se masa e përkohshme e vënë për qëllim sigurie, diferenca do të kthehet në rastin e obligacionit apo do të rimbursohet me një nivel interesi bankar për garancinë në rastin e depozitave në cash.

Kur Zyra Antidumping bën një përcaktim përfundimtar, mohues, çdo garanci e dhënë gjatë periudhës së zbatimit të masave të përkohshme duhet të shlyhet brenda 45 ditëve.

#### PJESA V

#### **KOHËZGJATJA, RISHIKIMI DHE RIKTHIMI I SHUMËS SË MBLEDHUR TË TAKSAVE ANTIDUMPING**

#### Neni 35

#### **Kohëzgjatja**

1. Një taksë antidumping duhet të mbetet në fuqi për aq kohë dhe në masën e nevojshme për të luftuar dumpingun që shkakton dëm pasuror.

2. Çdo masë përfundimtare antidumping do të hiqet jo më vonë se pesë vjet nga vendosja e saj ose nga data e rishikimit më të fundit, nëse ky rishikim mbulon njëherësh dumpingun dhe dëmin pasuror. Zyra Antidumping gjatë vitit të fundit para heqjes së masës, duhet të botojë një njoftim për afrimin e afatit të përfundimit të masës antidumping në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në një gazetë vendase mjaft të përhapur. Megjithatë masat definitive mund të mos hiqen nëse Zyra Antidumping, gjatë një rishikimi të filluar para afatit të skadimit, me nismën e vet ose me një kërkesë të arsyetuar, nga ose në emër të industrisë shqiptare, dërguar brenda 45 ditëve nga njoftimi publik për afrimin e afatit të mbylljes të masave përkatëse përfundimtare antidumping, dhe jo më vonë se 90 ditë para datës së skadimit të këtyre masave, përcakton se heqja e këtyre masave mund të çojë në rishfaqjen e dumpingut dhe të dëmit pasuror. Taksa mund të mbetet në fuqi në varësi të rezultatit të një rishikimi të tillë.

Neni 36  
**Rishikimi**

Zyra Antidumping duhet ta rishohë nevojën e vazhdimit të taksës, kur kërkohet me nismën e vet, ose me anën e një kërkesë të shkruar nga njëra nga palët e interesuara, kërkesë që përmban njoftimin i cili argumenton kërkesën për rishikim, me kusht që të këtë kaluar një periudhë e arsyeshme kohe, që nga vendosja e taksës përfundimtare antidumping. Me fillimin e rishikimit, Zyra Antidumping duhet të njoftojë palët e interesuara.

Sipas këtij neni, në procedurën e rishikimit Zyra Antidumping duhet të shqyrtojë me kërkesën e njëres nga palët e interesuara, nëse vazhdimi i taksës është i domosdoshëm për të kompensuar dumpingun, nëse dëmi pasuror ka të ngjarë të vazhdojë ose të rishfaqet, nëse hiqet apo ndryshon taksa, apo të dyja mundësitë njëkohësisht. Në rast se si rezultat i rishikimit sipas këtij neni, Zyra Antidumping përcakton se taksa antidumping nuk është më e nevojshme, ajo duhet të hiqet menjëherë.

Neni 37  
**Rikthimi i shumës së mbledhur të taksave**

1. Importuesit i kthehet shuma e mbledhur e taksave antidumping nga organet doganore nëse Zyra Antidumping përcakton se kufiri i dumpingut, mbi bazën e të cilit janë paguar taksat, është zhdukur ose reduktuar në nivel me të ulët se taksa në fuqi.

2. Importuesi duhet t'i dërgojë Zyrës Antidumping një kërkesë për kthimin e shumës së taksave antidumping të paguara brenda gjashtë muajve nga data kur organet doganore kanë vërtetuar vlerën e taksave përfundimtare për t'u mbledhur, ose nga data e vendimit për mbledhjen përfundimtare të vlerave të depozituara si masa të përkohshme.

Kërkesa duhet të përmbajë të dhëna mbi shumën e taksave antidumping të shpallura, për periudhën që do të kthehen dhe të gjitha taksat e tjera doganore të lidhura me llogaritjen dhe pagesën e një sasive të tillë. Kërkesa do të përfshijë edhe dokumentet e vlerave normale dhe të çmimeve të eksportit në Republikën e Shqipërisë për eksportuesin ose prodhuesin ndaj të cilit zbatohen taksat. Në rast se importuesi nuk është i lidhur me prodhuesin ose eksportuesin dhe një informacion i tillë nuk është menjëherë disponibël, ose kur prodhuesi ose eksportuesi nuk pranon t'ia japë atë importuesit, kërkesa duhet të përmbajë një deklaratë nga prodhuesi ose eksportuesi që kufiri i dumpingut është reduktuar ose zhdukur dhe se të dhënat justifikuese do t'i jepen drejtpërdrejt Zyrës Antidumping. Kërkesa refuzohet kur të dhëna të tilla nuk paraqiten nga eksportuesi apo prodhuesi brenda një periudhe të arsyeshme kohe.

3. Gjatë hetimit sipas kërkesës për rikthimin e shumës së mbledhur nga taksat Zyra Antidumping duhet të zbatojë dispozitat përkatëse të këtij ligji, për të bërë përcaktimet e nevojshme. Në veçanti, kur përcaktohet nëse dhe në çfarë mase duhet bërë një rikthim i tillë, kur çmimi i eksportit nuk është i besueshëm, sipas nenit 6 pika 2 të këtij ligji, Zyra Antidumping duhet të marrë në konsideratë çdo ndryshim në vlerën normale, çdo ndryshim në kostot, që kanë ndodhur ndërmjet importimit dhe rishitjes.

Zyra Antidumping duhet t'i japë importuesit, që ka bërë kërkesën, një shpjegim të hollësishëm për arsyet e vendimit lidhur me kërkesën për rikthim të shumës.

4. Rikthimi i shumës së mbledhur të taksave si rregull duhet të bëhet brenda 12 muajve dhe në asnjë rast më vonë se 18 muaj, që nga data kur është paraqitur kërkesa për rikthim. Çdo rikthim, duke i shtuar edhe interesin bankar për garancitë, duhet të bëhet brenda 90 ditëve nga vendimi për rikthim. Afatet kohore, të përmendura në këtë paragraf, mund të mos respektohen kur përcaktimi për të zbatuar taksat në fjalë është subjekt i procedurave të rishikimit gjyqësor.

PJESA VI  
RISHIKIMI GJYQËSOR DHE SANKSIONET

Neni 38  
**Rishikimi gjyqësor**

Çdo palë e interesuar, që ka marrë pjesë në një procedurë hetimi, rishikimi ose kthimi parash, mund të kërkojë, me anë bisedimesh, një rishikim të menjëhershëm të vendimeve të marra nga Zyra Antidumping, për përcaktimet përfundimtare, rishikimin e përcaktimeve dhe përcaktimet e kthimit të parave dhe në rast se në përfundim të bisedimeve çmon se kërkesa e saj nuk është marrë parasysh padrejtësisht, ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës kompetente në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile.

Neni 39  
**Sanksionet**

Përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen nga Zyra Antidumping, me gjobë jo me pak se 100.000 (njëqind mijë) lekë dhe jo me shumë se 400.000 (katërqind mijë) lekë palët e përfshira në hetim, që kundërshtojnë dhënien e informacionit të disponueshëm të kërkuar, nga Zyra Antidumping gjatë një hetimi, në përputhje me nenin 24 pika 1 të këtij ligji.

Ankimi kundër këtyre sanksioneve bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit “Për kundërvajtjet administrave”.

PJESA VI  
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 40  
**Detyrime ndërkombëtare**

Ky ligj do të zbatohet në përputhje me detyrimet që do të këtë Shqipëria për anëtarësimin në Organizatën Botërore të Tregtisë dhe veçanërisht me ato që rrjedhin nga marrëveshja për zbatimin e nenit VI të GATT 1994, “Për masat antidumping”.

Neni 41

Ngarkohet Këshilli i Ministrave për nxjerrjen e akteve nënligjore për:

- organizimin dhe funksionimin e Zyrës Antidumping;
- përcaktimin dhe plotësimin e formularëve;
- përmbajtjen e njoftimit publik për fillimin e hetimit;
- informacionin konfidencial;
- regjistrimin publik të zyrës antidumping;
- përmbajtjen e njoftimit për vendimin përfundimtar”

Neni 42

Ky ligj hyn në fuqi 6 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2341, datë 2.4.1999 të Presidentit të Republikës të Shqipërisë,  
Rexhep Meidani**

